REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. 4439 Prot

Maliq, më 16.7.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. 9, datë 16.7. 2026

PËR

"Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 2, datë 08.01.2026 "Rishqyrtim i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 147, datë 24.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë", i ndryshuar"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", neni 29/1, shkronja "a", neni 54, shkronja "ç", ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.05.2023 *"Për klasifikimin e e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendor, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 2, datë 08.01.2026 "*Rishqyrtim i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 147, datë 24.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë",* i ndryshuar,

PROPOZOJ:

I. Të miratoj disa shtesa dhe ndryshime në strukturën organizative të Bashkisë Maliq si më poshtë:

1- Në strukturën e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, në lidhja nr. 2 të bëhen disa ndryshime si më poshtë:

- "Sektori i Politikave Sociale" ndryshon emërtim dhe bëhet "Sektori i Politikave Sociale dhe Diasporës".
- Pozicioni "Punonjës Social + Arsimi" në "Sektorin e Politikave Sociale dhe Diasporës", ndryshon emërtim dhe bëhet "Punonjës Social + Diasporës".

2- Në strukturën e Sektorit të Bujqësisë dhe Ushqimit, në lidhja nr. 3 të bëhet një ndryshim si më poshtë:

- Në "*Zyrën Bujqësisë*", të ndryshohet paga për pozicionin e punës "***Nëpunës Zyre/Statistikë***", Klasa IV-3, me pagë grupi nga 10-14.000, paga për pozicion në masën **65.000** (*gjashtëdhjetë e pesë mijë*) lekë dhe shtesë 0.6-1% për vjetërsi në punë.

3- Në strukturën e Drejtorisë së Kulturës, në lidhja nr. 4 të bëhet një shtesë si më poshtë:

- Në "*Sektori Mbështetës*", të shtohet pozicioni i punës "***Teknik ndriçimi + audio***", me kod (*3521.14*), Klasa "Pika 11", paga për pozicion në masën **57.000** (*pesëdhjetë e shtatë mijë*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë.

4- Në strukturën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, në lidhja nr. 5 të bëhet një shtesë si më poshtë:

- Në "*Sektorin e Shërbimeve Nj. Ad. Pojan*", të shtohet pozicioni i punës "***Trajner i moshave***", me kod (*3422.16*), Klasa "Pika 11", paga për pozicion në masën **50.000** (*pesëdhjetë mijë*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë, me 8 orë pune.

5- Në strukturën e Sektorit të Rrugëve Rurale, në lidhja nr. 8 të bëhen disa ndryshime si më poshtë:

- Të ndryshohet paga për pozicionin e punës ***"Punëtor krahu mirëmbajtje-Mesmal"***, Klasa "Pika 11", paga për pozicionin bëhet në masën **43.750** (*dyzet e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë, me 7 orë pune.

II. Efektet financiare fillojnë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe përballohen nga buxheti i miratuar i Bashkisë Maliq për vitin 2026.

III. Për nxjerrjen e urdhrit për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar.

Konceptoi: N. Çaushi _____ Dt. ____/____/2026

A. Muka _____ Dt. ____/____/2026

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

_____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI

Nr. 4438 Prot. Maliq, më 16.7.2026

RELACION

Për

"Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 2, datë 08.01.2026 "Rishqyrtim i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 147, datë 24.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë" i ndryshuar"

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Maliq

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", neni 29/1, shkronja "a", neni 54, shkronja "ç", ligjin nr.152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.05.2023 *"Për klasifikimin e e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendor, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeeverisajes vendore*", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 87, datë 06.02.2026 "*Për disa ndryshime në Vendimin nr. 326, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike", të ndryshuar*",

Sipas projekt-vendimit të paraqitur, propozohet që në strukturën organizative të Bashkisë Maliq miratohen disa shtesa dhe ndryshime si më poshtë:

1- Në strukturën e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, në lidhja nr. 2 të bëhen disa ndryshime si më poshtë:

- "Sektori i Politikave Sociale" ndryshon emërtim dhe bëhet "Sektori i Politikave Sociale dhe Diasporës".
- Pozicioni "Punonjës Social + Arsimi" në "Sektorin e Politikave Sociale dhe Diasporës", ndryshon emërtim dhe bëhet "Punonjës Social + Diasporës".

Argumentimi : Këto ndryshime bëhen për efekt të krijimit të strukturës përgjegjëse për diasporën dhe migracionin, sipas përcaktimeve të nenit 29/1, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar.

2- Në strukturën e Sektorit të Bujqësisë dhe Ushqimit, në lidhja nr. 3 të bëhet një ndryshim si më poshtë:

- Në "*Zyrën Bujqësisë*", të ndryshohet paga për pozicionin e punës "***Nëpunës Zyre/Statistikë***", Klasa IV-3, me pagë grupi nga 10-14.000, paga për pozicion në masën **65.000** (*gjashtëdhjetë e pesë mijë*) lekë dhe shtesë 0.6-1% për vjetërsi në punë.

Argumentimi : Ndryshimi i pagës për këtë pozicion pune bëhet për efekt të ngarkesës që ka ky sektor. Për këtë pozicion pune do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.

3- Në strukturën e Drejtorisë së Kulturës, në lidhja nr. 4 të bëhet një shtesë si më poshtë:

- Në "*Sektori Mbështetës*", të shtohet pozicioni i punës "***Teknik ndriçimi + audio***", me kod (*3521.14*), Klasa "Pika 11", paga për pozicion në masën **57.000** (*pesëdhjetë e shtatë mijë*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë.

Argumentimi : Kjo shtesë pozicioni pune bëhet për efekt të menaxhimit të punëve në Drejtorinë e Kulturës. Për pozicionin e punës që shtohet do të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

4- Në strukturën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, në lidhja nr. 5 të bëhet një shtesë si më poshtë:

- Në "*Sektorin e Shërbimeve Nj. Ad. Pojan*", të shtohet pozicioni i punës "***Trajner i moshave***", me kod (*3422.16*), Klasa "Pika 11", paga për pozicion në masën **50.000** (*pesëdhjetë mijë*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë, me 8 orë pune.

Argumentimi : Kjo shtesë pozicioni pune bëhet për efekt të menaxhimit të punëve në Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Për pozicionin e punës që shtohet do të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

5- Në strukturën e Sektorit të Rrugëve Rurale, në lidhja nr. 8 të bëhen disa ndryshime si më poshtë:

- Të ndryshohet paga për pozicionin e punës ***"Punëtor krahu mirëmbajtje-Mesmal"***, Klasa "Pika 11", paga për pozicionin bëhet në masën **43.750** (*dyzet e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë, me 7 orë pune.

Argumentimi : Ndryshimi i pagës për këtë pozicion pune bëhet për efekt të ngarkesës që ka ky sektor. Për këtë pozicion pune do të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

6- Efektet financiare fillojnë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe përballohen nga buxheti i miratuar i Bashkisë Maliq për vitin 2026.

Në kompetencën Tuaj ligjore, përcaktuar në nenin 54 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak", gërma (ç), të Ligjit Nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", i ndryshuar, ju paraqesim për miratim e projekt-vendimit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj!

Konceptoi: N. Çaushi _____ Dt. ____/____/2026

A. Muka _____ Dt. ____/____/2026

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

_____